



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

SHPLLJE PËR POZICIONIN SPECIALIST

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”.

**Specialist i Burimeve Njerëzore në Sektorin Juridik & Burimeve Njerëzore,
në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë
Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve**

Afati për dorëzimin e dokumenteve 28/06/2024 pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Përpilon, ndjek dhe zbaton procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë, menaxhimin e dosjeve të personelit, masat disiplinore, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve etj.
- Harton database mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me lëvizjen e punonjësve, vlerësimin e rezultateve në punë, menaxhimin e dosjeve të personelit, mbushjes së moshës së pensionit sipas viteve etj.
- Ofron të dhëna dhe informacione mbi indikatorët e menaxhimit të burimeve njerëzore, rezultatet e vlerësimeve në punë, leje vjetore, leje lindjeje, raporte mjeko-ligjore etj.
- Përditëson dhe administron sistemin elektronik të regjistrimit të personelit HRMIS.
- Ofron mbështetje në procesin e hartimit të strukturës dhe organikës së institucionit.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve, të nivelit “Bachelor”, në shkenca Shoqërore;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

- f. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;

- g. Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe organizuar punën;
- h. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- i. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- j. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- k. Të kenë aftësi të mira të procedurave administrative;
- l. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
 - b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes së notave;
 - c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
 - d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
 - e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
 - f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
 - g. Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;
 - gj. Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
 - h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në vitin e fundit;
 - i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në MTM brenda datës 28/06/2024

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TE DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të MTM, www.turizmi.gov.al, tek kategoria/menuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me organizimin e veprimtarisë së punës;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në MTM do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të ministrisë.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës 28.06.2024 në protokollin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën 8.07.2024, në ambientet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;